




Shkolla Franko-Shqiptare
12-vjeçare
“ERNEST KOLIQI”





Mësimdhënie CILËSORE
Edukatë PUNE
Kërkesë E LARTË
Rigorozitet
Mendim KRITIK

Shkolla Franko-Shqiptare "Ernest Koliqi"

Jean-Pierre Le Goff President

Francia dhe Shqipëria kanë një lidhje të veçantë me njëra-tjetrën. Ndryshe nga vende të tjera, Franca ka qenë gjithmonë një atdhe i dytë për shumë intelektualë shqiptarë. Prandaj kjo lidhje, përpara se të jetë ekonomike apo politike, ka qenë një lidhje arsimore e kulturore.

Pikërisht në këtë traditë të bashkëpunimit arsimor është themeluar edhe Shkolla Franko-Shqiptare "Ernest Koliqi". Kjo shkollë, i krijuar nga një grup miqsh francezë dhe shqiptarë, synon të kombinojë traditën e arsimin francez dhe shqiptar me profesionalizmin dhe energjinë e një stafi të përkushtuar, për t'u ofruar të rinjve të Tiranës një shkollim elitë që do t'i përgatisë për universitetet më të mira dhe një botë konkurruese.



Ermal Hasimja Administrator

Si pedagog në universitet, njoh çdo vit studentë të sapodalë nga bankat e gjimnazit. Problemet janë të shumta, por lidhen kryesisht me mungesën e rigorozitetit dhe mendimit kritik nëpër shkollat tona. Kjo shkakton vështirësi të mëdha tek studentët kur përballen me kërkesat universitare.



Si prind, dëshiroj që fëmijët e mi të marrin një shkollim serioz, jo me nota fiktive siç ndodh shpesh në shkollat tona, por me kulturën e punës sistematike dhe vlerësim rigoroz.

"Ernest Koliqi," është frymëzuar pikërisht nga nevoja për zgjidhjen e këtyre problemeve. Ne mendojmë se sot në Shqipëri ekziston një kategori prindërishe dhe nxënësish që kërkojnë shkollim serioz, me kërkesë të lartë llogarë, që nxit pasionin për librin, mbështetur në studimin përmes logjikës e mendimit kritik dhe me të gjithë kushtet për të përgatitur të rinjtë tanë për universitetin, por edhe për një jetë konkurruese me vështirësi të panumërta.

Një shkollë për të rinjtë me ambicie të mëdha. Një shkollë për më të mirët.

Mirela Berisha Drejtoreshë

Gjatë viteve të punës si drejtuese në sistemin arsimor publik, kam pasur fatin të punoj me kolegë, mësues të mrekullueshëm me shumë pasion dhe dëshirë për profesionin e tyre. Gjithashtu jam ndjerë me fat edhe për të gjithë ata nxënës me plot dëshirë për dije dhe ambicie për një arsimim serioz. Por shpeshherë ndjehesh keq për të gjithë problemet që hasen në shkollat tona publike apo private. Gjithmonë më ka munduar pyetja: "Vërtet është kaq e vështirë të bësh një shkollë model?"

Unë jam tashmë pjesë e stafit drejtues të shkollës "Ernest Koliqi", për t'i dhënë vetes time dhe të gjithë atyre që i mundon e njëjta pyetje, një përgjigje të thjeshtë. Me ide të qarta, profesionalizëm, rigorozitet dhe përkushtim, një shkollë model është plotësisht e mundur.



Filozofia jonë

Të gjithë i njohim problemet e shkollave në Shqipëri. Megjithatë funksionimi i një shkolle të mirë është i vështirë, por plotësisht i realizueshëm nëse punohet me përgjegjësi dhe përkushtim. Prandaj në shkollën franko-shqiptare "Ernest Koliqi" ne udhëhiqemi nga 7 parimet e mëposhtme:

- ▶ Të gjithë nxënësit konsiderohen dhe trajtohen të barabartë. Secilit nxënës i jepet vëmendje maksimale individuale, por askush nuk privilegjohehet. Secili merr notën që meriton.
- ▶ Çdo nxënës është i aftë të mendojë në mënyrë kritike, krijujë e të pavarur. Të mësuarit përmendësh shmangjet përmes metodës së mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve. Niveli i gjimnazit përfshin lëndën e "Logjikës dhe mendimit kritik" në kurrikulumin e tij.

- ▶ Çdo nxënës ka individualitetin, personalitetin dhe prijet e tij dhe ne synojmë t'i nxisim ato në përfitim të tij.
- ▶ Prindërit janë partnerët tanë më të rëndësishëm dhe komunikimi me ta është thelbësor në arritjen e rezultateve.
- ▶ Puna e mësuesit me nxënësit nuk mbaron në klasë, por vetëm fillon aty. Për këtë arsye, mësuesit komunikojnë, monitorojnë, mbështesin dhe inkurajojnë nxënësit edhe pas përfundimit të mësimit përmes diskutimit në zyrë ose angazhimit në klubet e shkollës.
- ▶ Metodat e reja të mësimdhënies e bëjnë mësimin jo vetëm efikas, por edhe të këndshëm. Të mësuarit serioz nuk ka pse të jetë stresues, ose i mërzitshëm.
- ▶ Një shkollë e mirë nuk nxjerr vetëm nxënës të aftë, por edhe qytetarë të përgjegjshëm.

Për të realizuar këto parime punon një staf i kualifikuar e me përvojë, i përbërë nga mësues shqiptarë e të huaj. Infrastruktura, teknologjia dhe kushtet e tjera e bëjnë shkollën tonë një mjedis të përshtatshëm për mësim.

Ne besojmë tek nxënësit tanë. Ne besojmë se secili prej tyre ka një të ardhme të suksesshme përpara tij dhe misioni ynë është ta ndihmojmë ta krijojë që tani.

Strukturimi i mësimit

9-vjeçarja

Plani mësimor dhe orari për shkollën 9-vjeçare do të jetë si më poshtë:

Për klasat I-rë dhe të II-të: Nxënësit do të zhvillojnë çdo ditë nga 5 orë, ku do të përfshihen të gjitha lëndët e planifikuara dhe në programet zyrtare të MASH-it dhe zhvillimi i gjuhës së huaj angleze 4 herë në javë. Gjithashtu janë planifikuar dhe dy herë në javë orë të lira që do të shfrytëzohen nga mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat individuale të nxënësve.

Për klasat III - V: Nxënësit do të zhvillojnë 3 herë në javë 5 orë dhe dy herë në javë 6 orë. Në klasën e tretë futet si lëndë e re Informatika, ndërsa në klasën e pestë gjuha e huaj e dytë (frëngjishtja) që do të zhvillohet 2 herë në javë.

Për klasat VI- IX: Programi javor përmban 32 orë. Nxënësit do të kenë çdo ditë 6 orë dhe 2 herë në javë do të kenë 7 orë. Në ditët kur mësimi mbaron me 6 orë pjesa e mbetur e kohës do të përdoret nga mësuesi për punë individuale me nxënësit sipas nevojës.

Klasa	Ardhja në shkollë	Mëngjesi + lexim	Pushim	Fillimi i mësimit	Dreka	Studim konsultim	Kthimi në shtëpi
I + II	8 ⁰⁰ - 8 ¹⁵	8 ¹⁵ - 9 ⁰⁰		9 ⁰⁰	12 ¹⁵ -13 ⁰⁰		13 ⁴⁵
III-V	8 ⁰⁰ - 8 ¹⁵	8 ¹⁵ - 9 ⁰⁰		9 ⁰⁰	12 ¹⁵ -13 ⁰⁰	3 dite 13 ⁴⁵ -14 ³⁰	14 ³⁰
VI-IX	7 ⁴⁰ -7 ⁵⁰	-	9 ³⁵ - 9 ⁵⁰	8 ⁰⁰	13 ⁰⁵ - 13 ⁴⁰	3 dite 13 ⁴⁵ -14 ³⁰	14 ³⁰
X- XII	7 ⁴⁰ -7 ⁵⁰	-	9 ³⁵ - 9 ⁵⁰	8 ⁰⁰	13 ⁰⁵ - 13 ⁴⁰	3 dite 13 ⁴⁵ -14 ⁴⁵	14 ⁴⁵

Gjimnazi

"Ernest Koliqi" ofron shkollimin e të rinjve në gjuhën shqipe në të tre vitet e shkollës së mesme, sipas legjislacionit shqiptar. Regjistrimi kryhet përmes një procesi përzgjedhjeje që do të zhvillohet përmes një testi të brendshëm të shkollës të realizuar gjatë muajve maj-gusht. Pavarësisht se lëndët zhvillohen në shqip, anglishtes i vihet një theks i rëndësishëm (4-5 orë në javë me mësues anglezë dhe amerikanë), ndërsa frëngjishtja është gjuhë e dytë e huaj (2 orë në javë). Programi mësimor do të mbështetet në programin publik shqiptar (përveç lëndëve me zgjedhje të lirë që përcaktohen sipas nevojave të nxënësve), por tekstet shqiptare do të plotësohen me materiale shtesë që synojnë të përmirësojnë cilësinë e lëndës.



Mjediset e reja të shkollës



Aktivitetet

Një shkollë serioze duhet të ofrojë edhe mundësi argëtimi. "Ernest Koliqi" organizon aktivitetet e shumta për nxënësit: kampionatet e futbollit, notit, voleybollit e basketbollit për meshkuj e femra, konkurimet në teatër, poezi e pikturë, etj. Nxënësit që tërhiqen nga natyra mund të marrin pjesë në kampingun tonë buzë detit, ose fundjavat në zonat malore. Por mos harroni, "Ernest Koliqi" është një shkollë e vëmendshme ndaj mjedisit. Në çdo ekskursion, stafi dhe nxënësit pastrojnë edhe vendin që vizitohet. Gjithashtu shkolla është aktive në kujdesin ndaj atyre që kanë nevojë për ndihmë: të moshuarit, të varfërit, fëmijët e sëmurë, etj. Aktivitetet e planifikuara jashtëshkollore përshtaten me moshën e nxënësve.



Laboratori i fizikës



Laboratori i informatikës



Laboratori i kimisë

Ekskursion i gjimnazit me tenda kampingu në plazhin e Livadhit. Në program: lojëra, barbeky, vizitë kulturore.



Prej shtatorit të ardhshëm shkolla do të zhvendoset në mjediset e reja në dalje të Tiranës në rrugën dytësore që lidh Tiranën me Vorën. Mjediset e reja kanë një sipërfaqe rreth 5.400 m2 si dhe sipërfaqe shkollore (3 ndërtesa) rreth 4.500 m2. Shkolla 9-vjeçare do të jetë e ndarë nga gjimnazi. Shkolla do të ketë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për një shkollë moderne me laboratorët, hapësirat sportive, hapësirat e gjelbërta, bibliotekën, mjediset sanitare, një amfiteatër të madh dhe kuzhinën e mencën e saj.

Fundjavë në Dardhë

Ekskursion në shpellën e Pëllumbasit.

Administrata



President
M. Jean-Pierre Le Goff



Administrator
Dr. Ermal Hasimja




Drejtoreshë
Mirela Berisha



Departamenti i gjuhëve të huaja
Victoria Zurakowski



Aktivitetet artistike
Mimoza Verzivoli



Klubet jashtëshkollore
Elissa Thome



Asistente Administrative
Anisa Greva

Misioni

- ✓ Të ofrojë cilësinë më të lartë në arsimin e mesëm në Shqipëri, duke iu referuar standardeve më të mira perëndimore.
- ✓ Të formojë të rinjtë me frymën e mendimit kritik dhe sensin e logjikës gjatë mësimin.
- ✓ Të ngulisë kulturën e punës serioze dhe sistematike tek të rinjtë.
- ✓ Të nxisë aftësitë e punës individuale dhe asaj në grup.
- ✓ Të kultivojë prirjet e lidhshme dhe nismës individuale tek të rinjtë.
- ✓ Të nxisë të menduarit afatgjatë dhe planifikimit të së ardhmes.
- ✓ Të zhvillojë tek nxënësit kulturën qytetare dhe sensin e përgjegjshmërisë publike.

Stafi pedagogjik

Stafi pedagogjik i shkollës përbëhet nga mësues shqiptarë dhe të huaj (anglezë, amerikanë dhe francezë).

Të gjithë mësuesit, qoftë shqiptarë apo të huaj kanë përvojë në mësimdhënie dhe kanë dëshmuar përgatitje profesionale maksimale në angazhimet e mëparshme. Mësuesit shqiptarë janë përzgjedhur nga shkollat më të mira shqiptare.

Një pjesë e tyre janë shkolluar në universitetet perëndimore. Metoda e tyre e mësimdhënies bazohet në filozofinë e shkollës "Ernest Koliqi". Mësuesit e huaj janë të kualifikuar në nivel ndërkombëtar për lëndët që japin.



Ekskursion në Bylis



Loja më popullore në gjimnaz: "Mafia".



Kampionati i voleybollit me shkollat ndërkombëtare.



Duke u shërbyer drekën të moshuarve



Fundjavë në Theth



Ekskursion te Kepi i Rodonit.



Pyetje të shpeshta nga prindërit



1. Çfarë niveli kërkese ka shkolla franko-shqiptare "Ernest Koliqi"?

"Ernest Koliqi" është një shkollë që ofron cilësi të lartë mësimdhënie, por edhe shkollë që kërkon shumë prej nxënësve të saj. Ne besojmë se rezultatet e mira arrihen vetëm me punë serioze dhe sistematike. "Ernest Koliqi" është vendi i duhur për të rinjtë seriozë, punëtorë, të pasionuar dhe me ambicie për të ardhmen e tyre.

2. Çfarë garancie kam si prind për seriozitetin dhe cilësinë e shkollës?

"Ernest Koliqi" është krijuar nga një grup franko-shqiptar me synimin për të ofruar në Tiranë të njëjtin nivel që kanë shkollat perëndimore. Garancia e saj më e mirë janë serioziteti i themeluesve dhe i stafit. Shkolla ka përzgjedhur disa nga mësuesit më të mirë në shkollat më të mira të Tiranës, si dhe mësues të huaj me përvojë. Pika e referimit janë stardardet perëndimore. Shkolla ka shmanhur problemet themelore që dëmtojnë shkollat shqiptare: fiktiviteti i notës, mungesa e vëmendjes ndaj nxënësit, mësimi përmendësh, etj.

3. Në shkollat shqiptare disa nxënës privilegjojnë për shkak të statusit të prindit. A do të trajtohet çdo nxënës si i barabartë me të tjerët në vlerësim tek "Ernest Koliqi"?

Ne e konsiderojmë çdo nxënës të barabartë me gjithë të tjerët. Privilegjimi është i papranueshëm nga pikëpamja etike dhe profesionale, por gjithashtu ai e dëmton nxënësin në vend që ta ndihmojë. Prandaj, tek "Ernest Koliqi" askush nuk privilegjohet. Çdo nxënës është njësoj i rëndësishëm dhe asnjëri nuk është më i rëndësishëm se tjetri.

4. Çfarë risie sjell shkolla nga pikëpamja e metodës së mësimdhënies?

Zakonisht në shkollat shqiptare nxënësit theksi vihet tek magazinimi i informacionit nga nxënësi, gjë që e nxit atë shpesh të mësojë përmendësh. Tek "Ernest Koliqi" metoda e mësimdhënies dhe ajo e kontrollit të dijes shmangin të mësuarit përmendësh dhe nxisin mendimin kritik

autonom. Kështu në klasë mësuesi kërkon angazhimin e nxënësve në procesin e mësimit, ndërsa në kontrollin e dijes kërkon përdorimin autonom të njohurive në funksion të analizës, kuptimit dhe shpjegimit të dukurive dhe jo riprodhimin e informacionit. Në qoftë se nëpër shkollat shqiptare, këto metoda zbatohen vetëm nga mësues individualë, tek "Ernest Koliqi" kjo përbën thelbin e filozofisë së shkollës.

Përveç kësaj "Ernest Koliqi" është e vetmja shkollë që ka në kurrikulumin e saj lëndën e "Logjikës dhe mendimit kritik".

5. Në çfarë gjuhe zhvillohet mësimi?

Mësimi zhvillohet në shqip në të gjithë nivelet. Megjithatë ne i vëmë theks të veçantë mësimit të gjuhëve të huaja dhe sidomos anglishtes që nga cikli i ulët e deri në maturë. Frëngjishtja është gjuhë e dytë e huaj prej klasës së tretë e deri në maturë. Ndërkohë në rast interesimi të nxënësve mund të ofrohen edhe gjuhë të tjera të dyta të huaja.

6. A janë mësuesit të huaj apo shqiptarë?

Mësuesit janë shqiptarë dhe të huaj, në varësi të lëndës dhe të vitit. Për lëndët me zgjedhje nxënësit mund të marrin lëndë në anglisht (ose frëngjisht) me mësues të huaj, apo lëndë në shqip me mësues shqiptarë.

7. A mund të regjistrohet cilido në këtë shkollë?

Për nxënësit e klasave I-V regjistrimi bëhet pas një interviste me prindërit. Për nxënësit që transferohen nga shkolla të tjera në nivelet mbi klasën e V si dhe gjimnazin zhvillohet një test pranues në matematikë dhe letërsi. Përmes testit shkolla synon të përzgjedhë nxënës të mirë.

8. A do të ketë siguri të brendshme?

Natyrisht. Shkolla monitorohet nga personel i specializuar sigurie. Përveç sigurisë, stafi pedagogjik dhe ai i sigurisë ndalon çdo lloj veprimtarie të padëshiruar brenda territorit të shkollës.

9. Si do të informohen unë si prind?

Përveç pritjes së prindërve dhe informimit mbi ecurinë e nxënësit, shkolla informon menjëherë njërin nga prindërit për vonesat ose mungesat. Gjithashtu prindërit kanë mundësinë të shohin rregullisht notat e nxënësit përmes një linku në Internet. Përveç notave dhe mungesave prindi informohet me e-mail edhe për çështje të veçanta sipas nevojës: veprimtari jashtë-shkollorë, punime të shkëlqyera nga nxënësi, probleme sjelljeje, etj. Në rastet e nevojshme mësuesi, psikologjia apo drejtoresha mund të kërkojë takim me prindin përmes telefonit.

10. Çfarë aktivitete të tjera ofron shkolla përveç mësimit?

Te "Ernest Koliqi" ne investojmë tek nxënësit që duan të zhvillojnë prirjet e tyre përtej orëve të mësimit. Ne besojmë se çdo nxënës ka talentet specifike dhe detyra jonë është t'i zhvillojmë ato. Prandaj në nivelin e gjimnazit shkolla ofron pjesëmarrjen në klube të ndryshme (p.sh. klubi i kinemasë, klubi i filozofisë, klubi i fotografisë, klubi i ekologjisë, etj) të drejtuar nga vetë mësuesit ose nga ekspertë të ftuar nga shkolla. Për disa nga klasat e shkollës 9-vjeçare është parashikuar një klub leximi i cili synon të rrënjosë te nxënësit edukatën e leximit jashtëshkollor si dhe të zhvillojë aftësitë e prezantimit të teksteve të lexuara përpara klasës.

Shkolla organizon ekskursione kryesisht në vjeshtë dhe pranverë. Deti dhe mali janë dy mjediset e preferuara. Me qëllim të lidhjes me botën përtej mureve të shkollës, shpesh ftohen personazhe publikë dhe specialistë të fushave të ndryshme për të ndarë me nxënësit përvojat e tyre në amfiteatrin tonë. Shkolla organizon gjithashtu konkurse me tematika të ndryshme me pjesëmarrjen e nxënësve (poezi, fotografi, ese, etj). Nën drejtimin dhe shoqërimin e stafit, nxënësit vizitojnë mjedise profesionale për t'u njohur nga afër me procese të ndryshme pune. Gjithashtu nxënësit ftohen të ideojnë apo të marrin pjesë në projekte që synojnë kultivimin e sensit të përgjegjësisë qytetare (p.sh. mbledhja e ndihmave për kategori në nevojë, pastrimi i mjedisit, etj). Për nxënësit e 9-vjeçares janë planifikuar aktivitete jashtëshkollorë dhe ekskursione në përshtatje me moshën e tyre. Qëllimi nuk është vetëm argëtimi, por edhe edukimi.

11. A ka shkolla zyrë psikologu?

Natyrisht. Shkolla ka psikologun e saj, me përvojë në komunikimin me nxënësit e kësaj grup-moshe. Psikologjia bashkëpunon ngushtë me stafin pedagogjik për të kuptuar dhe trajtuar sa më mirë nevojat individuale të nxënësve.

12. A mjaftohet komunikimi me nxënësin vetëm gjatë orës së mësimit?

Jo, aspak. Pas përfundimit të mësimit, mësuesit janë përsëri në dispozicion të nxënësve për të punuar individualisht sipas nevojës, njësoj si në shkollat perëndimore. Nxënësit mund të këshillohen me mësuesit rreth çështjeve mësimore, ndonjë vështirësi të kuptimit të mësimit, në rast interesi për të lexuar më tepër rreth një teme të caktuar, etj. Këshillimi është pjesërisht i detyrueshëm sipas një orari të caktuar nga drejtorja për çdo nxënës, sepse i jep mundësinë mësuesit të ndjekë nga afër ecurinë e nxënësit. Përtej kësaj, çdo këshillim tjetër është fakultativ dhe varet nga interesi i nxënësit. Në rast se është e nevojshme në këtë këshillim mund të marrë pjesë edhe prindi.

13. A mund të transferohet një nxënës nga një shkollë tjetër tek ju dhe anasjelltas?

Një nxënës mund të transferohet nga një shkollë tjetër tek "Ernest Koliqi" vetëm pas kalimit të një testi të brendshëm që konfirmon një nivel të mirë të arritur në shkollën para-prake.

14. A do të jetë shkolla stresuese për nxënësit?

Procesi i mësimit mund të jetë stresues vetëm kur nga nxënësi kërkohet të mësuarit përmendësh dhe kur mësuesi nuk kupton nevojat dhe prirjet e nxënësit. "Ernest Koliqi" përdor metoda bashkëkohore mësimdhënie që synojnë jo vetëm përvetësimin e njohurive nga nxënësi, por edhe bërjen e orës së mësimit sa më tërheqëse për të. Shkolla jonë synon të nxisë tek nxënësi pasionin për dijen.

15. A ka shkolla infrastrukturën e nevojshme?

"Ernest Koliqi" plotëson dhe tejkalon të gjithë parametrat e përcaktuara me ligj për infrastrukturën. 9-vjeçarja dhe gjimnazi janë të ndarë në mënyrë të tillë që nxënësit të jenë të rrethuar vetëm nga grupmosha e tyre. Shkolla ka një hapësirë prej rreth 5.400 m² dhe një sipërfaqe të shfrytëzuar ndërtese prej rreth 5.000 m². Mjediset ofrojnë kushte optimale për mësimin si dhe aktivitete të ndryshme sportive, kulturore e sociale. Për shkak të theksit të veçantë që vihet tek lëndët shkencore, shkolla ka laboratorë të pajisur me të gjithë mjetet e nevojshme didaktike.

16. A do të ndihmojë shkolla tranzicionin e nxënësve të gjimnazit në universitet?

Po. Duke patur parasysh se "Ernest Koliqi" është e orientuar tek nxënësit më të mirë dhe cilësia maksimale, ajo përgatit nxënësit për hapin e mëtejshëm: universitetin. Shkolla ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për universitetet në Shqipëri, por mbi të gjitha ndihmon nxënësit e interesuar për të studiuar jashtë vendit me identifikimin e shkollës sipas degës, vendit dhe mundësive për bursa për më të mirët. Shkolla gjithashtu ndihmon nxënësit në përgatitjen e dosjeve të aplikimit për universitetet e huaja.

17. A ka "Ernest Koliqi" restorant shkollor?

Po, shkolla ka edhe një restorant me çmime të barabarta me koston e shërbimit, me një vëmendje të veçantë tek dieta e ekuilibruar.

18. A ofron shkolla transport për nxënësit?

Shkolla ofron shërbimin e transportit sipas orareve të mësimve me furgonë të përshtatshëm dhe komodë.

Biblioteka

Biblioteka ka në fondin e saj, në shqip, anglisht dhe frëngjisht. Klubi i leximit me nxënësit më të vegjël synon nxitjen e dashurisë për librin dhe edukatën e leximit jashtëshkollor. Shkolla siguron akses të drejtpërdrejtë dhe falas në miliona tekste elektronike në anglisht në libraritë online ku është abonuar. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi jepen nga përgjegjësja e bibliotekës. Përgjegjësja e bibliotekës është në shërbim të nxënësve për gjetjen e teksteve, për ndihmën në identifikimin e teksteve të përshtatshme, si dhe për përdorimin e librarive online.



Procedura e regjistrimit dhe testi pranues

Për 9-vjeçaren

Për nxënësit e klasave I-V regjistrimi bëhet pas një interviste me prindërit. Për nxënësit që transferohen nga shkolla të tjera në nivelet mbi klasën e V zhvillohet një test pranues në matematikë dhe letërsi.

Për gjimnazin

Meqenëse gjimnazi synon të përzgjedhë nxënësit më të mirë regjistrimi nuk është automatik, por selektiv.

Procedura e regjistrimit përfshin:

1. Shqyrtimin e mesatares së shkollës 9-vjeçare (nxënësit që do të paraqiten përpara përfundimit të klasës së 9 duhet të sjellin listën e notave të deritanishme. Në rast se kjo është e vështirë për vetë nxënësit, vetë gjimnazi do të kontaktojë shkollat përkatëse për të marrë notat).
2. Realizimin e një testi nga vetë gjimnazi në lëndët e matematikës dhe letërsisë.
3. Zhvillimin e një interviste me stafin e shkollës për të njohur më mirë motivimin dhe prirjet e nxënësit.

E njëjta procedurë vlen edhe për nxënës të cilët dëshirojnë të transferohen tek "Ernest Koliqi" nga shkolla të tjera të mesme. Në rast të përbushjes me sukses të procedurës nxënësi mund të regjistrohet. Shkolla nuk do të pranojë nxënës që kanë patur sjellje të papërshtatshme në 9-vjeçare edhe nëse ata i përbushin kriteret e mësipërme.

Për informacione të përgjithshme mbi shkollën mund të vizitoni uebsajtin tonë zyrtar www.ernestkoliqi.com si dhe faqen tonë në [Facebook](https://www.facebook.com/ernestkoliqi).



Këshillimi

Shkolla aplikon një sistem të ngjashëm me atë universitar përsa i përket këshillimit, për t'i përgatitur paraprakisht nxënësit për atë që i pret në shkollën e lartë. Këshillimi zhvillohet në tre aspekte: psikologjik, mësimor dhe ai i karrierës.

1. Këshillimi psikologjik i realizuar nga një psikologe profesioniste synon:

- Të monitorojë ecurinë psikologjike të nxënësve duke parandaluar cdo lloj shqetësimi të mundshëm.
- Të garantojë përshtatjen sa më të mirë psikologjike me procesin mësimor.
- Të ndihmojë nxënësit me vështirësi përshtatjeje me klasën dhe mjedisin social në përgjithësi.
- Të nxisë nxënësit për të gjetur vetveten brenda shkollës dhe më tej.

Këshillimi psikologjik mund të bëjë të nevojshëm edhe praninë dhe pjesëmarrjen aktive të prindit.

Oraret e këshillimit psikologjik: Cdo të hënë, të mërkurë e të premte, nga ora 12.00-14.00 në zyrën e psikologes.

2. Këshillimi shkollor realizohet nga mësuesit e lëndëve sipas orareve të rregullta të shpallura paraprakisht në fillim të cdo semestri. Ky lloj këshillimi synon:

- Të inkurajojë zhvillimin e aftësive dhe talenteve të vecanta të nxënësit.
- Të ofrojë material shtesë për nxënësit që kërkojnë të lexojnë më tepër në një lëndë apo çështje të caktuar.
- Të mbështesë nxënësit që mund të hasin vështirësi në ecurinë e lëndës.
- Të mbështesë nxënësit pjesëmarrës në veprimtari jashtëshkollore si konkurse, olimpiada, etj.

3. Këshillimi i karrierës për gjimnazistët realizohet nga staf i specializuar dhe synon:

- Njohjen e nxënësit me mundësitë e vazhdimet të studimeve të larta brenda dhe jashtë vendit.
 - Ndihmën dhe orientimin në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimet për shkollimin në universitete të huaja.
 - Ofrimin e informacionit për pjesëmarrjen në veprimtari jashtëshkollore si konkurse, seminare, etj.
- Oraret e këshillimit të karrierës përcaktohen sipas rastit nga drejtorja dhe u njoftohen individualisht nxënësve.